

VENDIM
Nr. 978, datë 4.12.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 52, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2015”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, vlera “154 700 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind mijë) lekë”, ndryshohet dhe zëvendësohet me “112 049 122 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e dyzet e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë”.

2. Vlera prej 42 650 878 (dyzet e dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh, e papërdorur si bashkëfinancim për projektin IPA 2011, të përdoret për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, në përputhje me pikën 2, të vendimit nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama